

STATUTI
I SHOQERISE TREGTARE
“Seafood Market” Sh.p.k.

Sot, me date 08/11/2023, ortaket themelues:

Klajdi Kalliri, lindur në Tirane, më 21.11.1985, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, rezident ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal I51121036I,

Redi Kapoli, lindur në Tirane, më 19.05.1986, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, rezident ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal I60519090D,

Erald Myhedini, lindur në Tirane, më 14.07.1985, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, rezident ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal I50714024M,

Kane vendosur te themelojne shoqërine “Seafood Market” Sh.p.k dhe kane vendosur te miratojne dhe nenshkruajne statutin ne perputhje me kushtet si me poshtë:

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqeria Tregtare “Seafood Market” Sh.p.k. rregullon pozitën e saj juridike, marredhëniet e themeluesve, të organeve te saj, llojin e Shoqerisë, kohezgjatjen e veprimtarisë së saj, marredhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojne marredhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 1

Objekti i veprimtarisë

Objekti i Veprimtarise së Shoqërisë do të jetë por duke mos u kufizuar ne:

- Shitje me shumice e produkteve me origjine shtazore per njerez,
- Import i te gjitha produkteve me origjine nga deti si dhe te akuakultures si te gjitha llojet e peshkut dhe nenproduktet e tij, te gjitha llojet e guackave, te gjitha llojet e specieve me origjine detare ne gjendje te fresket, te ngrire, te kripura, te marinuara ne vaj, ne salce, ne vakum, te konservuara etj,
- Import i mjeteve/materialeve/makinerive ndihmese te nevojshme ne funksion te aktivitetit.
- Çdo veprimtari tjetër tregtare te lejuar me ligj.



NENI 2
Emri dhe selia e Shoqerise

Shoqeria është Person Juridik Privat.
Shoqëria do të paraqitet në qarkullim me emertimin e saj "Seafood Market" Sh.p.k.
Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane, Vore, Fshati Muçaj, Godine 1 kateshe ne zonen kadastrale 2726, bodrum.

NENI 3
Kohëzgjatja e Shoqerise

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe ka filluar me regjistrimin e shoqerise në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj një apo disa here, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 4
Regjimi Juridik i Shoqërisë

Shoqeria është një shoqeri me pergjegjesi të kufizuar (Sh.p.k.).
Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Pergjithshme, Shoqeria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese. Shoqeria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria ka vulën e saj.

NENI 5
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali i shoqerisë është në vlerën 10.000 leke, i ndare ne 3 (tre) kuota.

Ortaket e shoqerise zoterojne kuotat si me poshte:

Klajdi Kalliri zotëron 1 kuote te kapitalit themeltar te barabarte me 33.3% te tij ne vleren 3.330 leke.

Redi Kapoli zotëron 1 kuote te kapitalit themeltar te barabarte me 33.3% te tij ne vleren 3.330 leke.

Erald Myhedini zotëron 1 kuote te kapitalit themeltar te barabarte me 33.4% te tij ne vleren 3.340 leke.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total ne përputhje me kuotat e tyre.



NENI 6

Transferimi i kuotave

1. Ortaket mund të disponojnë kuotat e tyre, në veçanti mund ti transferojnë vetem ndermjet ortakeve themelues ose ti ngarkojnë ato me barre në përputhje me dispozitat e këtij neni.
2. Nëse një nga Ortaket ("Ortaku Zoterues") ka për qëllim të shese kuotat, Ortaket e tjere te shoqerise do të kenë të drejtën e parablerjes për kuotat e destinuar për transferim në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë nen.
3. E drejta e parablerjes mund të ushtrohet vetëm në lidhje me të gjitha kuotat që do të transferohen. Nëse disa Ortake njoftojnë synimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes, ata mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në përpjesëtim me numrin e kuotave që ata zoterojnë në kapitalin themeltar të shoqerise.
4. Ortaku zoterues do të njoftojë të gjithë ortaket e tjere për qëllimin e tij për të shitur kuotat dhe ky njoftim duhet të përfshijë çmimin dhe kushtet e transferimit. Ortaku zoterues do të ndajë kuotat ndërmjet ortakeve që shprehën qëllimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes, nese eshte me shume se nje ortak, në përputhje me pikën 3. Ortaku zoterues do të ndaje numrin e kuotave - sipas nevojës - tek secili ortak në mënyrë të tillë që numri i kuotave të jetë një numër integral, i cili lejon zbatimin sa më të plotë të pikës 3.
5. E drejta e parablerjes skadon nëse pergjigjja për ushtrimin e të drejtës së parablerjes nuk i dorëzohet nga ndonje prej ortakeve ekzistues, ortakut zoterues brenda 60 (gjashtedhjetë) ditëve nga data e njoftimit për shitjen e kuotave.
6. Nëse - para skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 5 - ortaket nuk ushtrojnë të drejtën e parablerjes, ortakut zoterues mund t'i ofrojë dhe t'i transferojë kuotat tek nje pale e trete respektivisht me te njejtin cmim dhe kushte te ofruara ortakeve te tjere. Transferimi i kuotave në përputhje me kushte të tjera nga ato të specifikuar në njoftim nuk lejohet dhe do të konsiderohet i pavlefshëm.
7. Cdo ortak mund të vendose barre mbi kuotat e tij, me pëlqimin paraprak të dhënë nga shoqeria. Pëlqimi që kuotat mund te barresohen jepet me shkrim nga Asambleja e Pergjithshme brenda 60 ditesh nga njoftimi mbi qëllimin e ortakut per te vendosur barre. Pas kalimit të afatit lartpërmendur, ortakut do të ketë të drejtë të vendose barre mbi kuotat e tij pa kufizime.
8. Çdo njoftim i referuar në këtë nen duhet të bëhet në formën e letrave të dërguara nëpërmjet postës me njoftim marrje.

NENI 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Pergjithshme. Zmadhimi i kapitalit mund te vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqerise duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.



Asambleja e Pergjithshme, vendos per zvogelimin e kapitalit të Shoqerise. Zvogelimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kane dhënë kredi para publikimit të zvogelimit të kapitalit.

NENI 8 **Bilanci**

Pasuria e Shoqerise vlerësohet në bilancet e saj në monedhë te vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqerise.

Bilanci vjetor depozitohet ne organet tatimore brenda dates 31 Mars të vitit pasardhës.

NENI 9 **Shpërndarja e fitimeve**

Ortakët kane të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqerise. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara respektivisht.

Shoqëria do te shpërndajë fitimet ortakëve ne fund te cdo viti financiar, pas miratimit te bilancit nga Asambleja e Ortakeve dhe ne perputhje me rregullat dhe ligjet ne fuqi.

II. ORGANET E SHOQERISE

NENI 10 **Asambleja e Pergjithshme**

Organi themelor i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per:

1. Percaktimin e politikave tregtare të shoqërise;
2. Ndryshimet e statutit;
3. Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
4. Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
5. Percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertët kontabël te autorizuar.
6. Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarise;
7. Miratimin e pasqyrave fnciariare vjetore dhe te raporteve të ecurise se veprimtarise;
8. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
10. Kufizimin e afatit te veprimtarise se shoqerise;
11. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
12. Çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 11

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme mblidhet sa here që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 12

Thirrja e Asamblesë se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo me vonë se 7 ditë përpara dates së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si me sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 13

Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë 75% të kuotave.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me sipër, asambleja mblidhet perseri jo me vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katertat e votave të ortakëve për të gjitha çështjet sipas statutit dhe ligjit.

NENI 14
Procesverbali i mbledhjes se asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

III. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 15
Administratoret

Asambleja e përgjithshme emëron një ose deri në tre persona fizik si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërteritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Administratori i Shoqërisë "Seafood Market" Sh.p.k. do të **Redi Kapoli**, lindur në Tiranë, më 19.05.1986, madhor e me zotësi të plote juridike e për të vepruar, rezident në Tiranë, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal I60519090D, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 16
Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

5. Krijojnë një sistem paralajmerimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Biznesit;
7. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
9. Therrasin asamblesën e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
10. Përfaqesojnë shoqërinë në gjykatë dhe para çdo autoriteti tjetër.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

NENI 17

Shpërblimi i administratorëve

Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i pershtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

IV. PRISHJA E SHOQËRISE. LIKUIDIMI

NENI 18

Prishja e shoqërisë

Kjo Shoqëri do të priset në rastet kur:

1. Merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
2. Hapen procedurat e falimentimit;
3. Nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i aktivitetit në Qendren Kombëtare të Biznesit në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Biznesit";
4. Merrret një vendim gjykatë.

Prishja e shoqërise regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

NENI 19 **Likuidimi i shoqërisë**

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjyqësues, për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjyqësues zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakeve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si me sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjyqësues. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 20 **Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjyqësues përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 21
Bilancet

Likuiduesi pergatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në castin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc perfundimtar në çastin e mbylljes së ketyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat me shumë se një vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Pergjithshme.

NENI 22
Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shperndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kane në ndarjen e fitimeve, me perjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i jane dhëne shoqërise me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve.

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombëtare të Biznesit per përfundimin e likuidimit dhe kërkon c' regjistrimin e shoqërisë.

V. DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 23

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

NENI 24

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në kete Statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me te në fuqi në Republikën e Shqiperise.

NENI 25


Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhen shqipe dhe nënshkruhet pa verejtje nga Ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES

Klajdi Kalliri



Redi Kapoli



Erald Myhedini

